



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komuna e Drenasit

Drejtoria për Shendetësi dhe Mirëqenie Sociale

06. Nr. 400/01-3013 dt. 23/07/ 2026



Lista preliminare e Aplikantëve për përfitim nga Bonusi i Banimit

Në bazë të thirrjes publike për aplikim për **Bonus Banim 06-070/01-21525 datë 08/06/2026**, dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantët, publikohet lista si vijon:

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nr.i Aplikimit	Vendbanimi	Statusi
1.	Mimoza Gajtani	06-070/01-24217 datë 24.10.2026	Drenas	Miratuar

Nënshkrimet e Komisionit:

1. Marigona Qorri-Dshms (Kryesuese)
2. Arlinda Kukaj-Dshms (Anëtarë)
3. Shpetim Nika-Qps (Anëtarë)
4. Bedri Morina-Qps (Anëtarë)
5. Adhuresa Berisha Duph (Anëtarë)



Kriteret sipas radhës së përparësisë me poenizim U. A.21/2010, BONUS BANIM 2026

[illegible]

Komisioni në përbërje:

1. MARIGONA QORRI (Kryetar)
2. ARLINDA KUKAJ (antare)
3. SHPËTIM NIKA (antare)
4. BEDRI MORINA (antare)
5. ADHURESA BERISHA (antare)

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	23/07/2026		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
06	400/01	30/09	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gllogocit
 Opština Gllogovac - Municipality of Gllogoc



Bazuar në dispozitat e nenit 44, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 14 dhe 17 i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 dhe dispozitave tjera të Ligjit nr. 10/L-022 Për Banim Social dhe të Përballueshëm, neni 5,6,7,8,10 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ-Nr. 19/2010 Për Përmbajtjen E Bonusit Të Banimit, vendimit të Kuvendit Komunal me numer 02.Nr.400/01-15720 te dt. 30.04.2026 si dhe vendimit me 01Nr.020/04-4396 për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për çështjet e banimit të përkohshëm social, me dt. 22.07.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e parashtruar nga Mimoza Gajtani e përfaqësuar nga kujdestarja ligjore Shukrije Xhemajlaj, me numër të protokollit 06-070/01-24217 e dt.24.06.2026
- II. **I JEPET** bonusi I banimit për shfrytëzimin e banesës me qira nga tregu i lirë;
- III. **REKOMANDOHEM** lidhja e kontratës për bonus banimin.

A R S Y E T I M

Mimoza Gajtani me dt.24.06.2026 e përfaqësuar nga kujdestarja ligjore Shukrije Xhemajlaj, ka parashtruar kërkesë në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për përfitim nga bonusi i banimit me numër të protokollit 06-070/01-24217.

Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës dhe vlerësimit të dokumentacionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi dispozitat ligjore konform nenit 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ për Përmbajtjen e Bonus Banimit Nr.19/2010". *Kuvendi komunal miraton dhënien e bonusit edhe ne rastet kur kërkuesi gjen individualisht banesën me qira të tregut për të cilën nuk është lidhur*

kontratë midis pronarit dhe organit kompetent komunal", nenit 7 të UA-19/2010, "Në rastet kur banesa, ku do të vendoset ose është vendosur familja, që aplikon për bonus, është gjetur nga vetë familja, organi kompetent komunal bënë verifikimin: e banesës, kushteve të banimit dhe qirasë që ofron pronari" si dhe nenit 17 të Ligjit Nr.10/L-022 për Banim Social dhe të Përballueshëm "Subvencioni nga komuna është pesëdhjetë përqind (50%) të qirasë për banimin në njësitë e banimit privat"

Gjetjet faktike të administruara:

- Kërkesa e dt. 24.06.2026 me nr. 06-070/01-24217;
- Dokumente identifikimi për aplikuesin dhe anëtarët e familjes;
- Aktvendim nga QPS me Nr. 512 të dt.01.07.2024;
- Kontrata për Qiranë e Banesës me Nr.4774/2026;
- Vendim i pensionit për persona me paaftësi të përhershme të Mimoza Gajtani;
- Raporte mjekësore;
- Kontrata e punës e Shukrije Xhemajlaj;
- Aktgjykim i Gjykatës për zgjidhje martesës, kujdestarisë dhe besim të fëmijëve;
- Fletlëshim nga Shërbimi Spitalor Klinik-Universitar i Kosovës me numër 231;
- Deklarata e papunësisë;
- Deklarata e bashkësisë familjare;
- Vërtetim i ARBK-së;
- Vërtetim i tatimit në pronë;
- Foto të gjendjes së banesës;

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha provat e administruara, Komisioni vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë rrethana të veçanta sociale që arsyetojnë përkrahjen përmes bonusit të banimit.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se **Mimoza Gajtani është person me aftësi të kufizuara të përhershme**, e cila për shkak të gjendjes së saj shëndetësore është nën kujdestarinë ligjore të nënës së saj, sipas aktvendimit përkatës të gjykatës.

Gjithashtu, Mimoza është nënë e fëmijëve të mitur, për të cilët kërkohet sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit dhe mirëqenies. Gjendja shëndetësore e aplikueses, pamundësia e saj për të siguruar në mënyrë të pavarur strehim, përgjegjësia për përkujdesjen ndaj fëmijëve, si dhe gjendja ekonomike e familjes, përbëjnë rrethana të jashtëzakonshme që e bëjnë të domosdoshëm ofrimin e mbështetjes institucionale.

Për këto arsye, Komisioni vlerëson se miratimi i bonusit të banimit është në përputhje me qëllimin e Ligjit për Banim Social dhe të Përballueshëm dhe Udhëzimit Administrativ, duke garantuar mbrojtjen e dinjitetit, sigurisë dhe interesit më të mirë të fëmijëve dhe të personit me aftësi të kufizuara.

Rrjedhimisht, Komisioni propozon miratimin e kërkesës për bonus banimi, duke konsideruar se plotësohen kushtet ligjore dhe se rrethanat e veçanta shëndetësore, sociale dhe familjare e bëjnë të domosdoshme mbështetjen nga Komuna dhe rekomandon lidhjen e kontratës për bonus banimin.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese me shkrim brenda afatit prej 30 ditësh në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor nga dita e publikimit të këtij vendimi.

Komisioni

Vendimi i dërgohet:

DSHMS-së;

Palës;

Zyrës së Kryetarit;

Marigona Qorri - DSHMS (kryesues)

Arlinda Kukaj – DSHMS (anëtarë)

Shpëtim Nika – QPS (anëtarë)

Bedri Morina – QPS (anëtarë)

Adhuresa Berisha – DUPH (anëtarë)

